



Frank Hackett, Ed.D.
Përgjegjës për shkollat

James Lee
Ndihmës përgjegjës për shkollat

Dhjetor 2019

Departamenti i Shkollave Publike i Braintree ka kënaqësinë t'ju njoftojë për fillimin e regjistrimeve në Kopsht për vitin shkollor 2020-2021. Dokumentacioni që zotërojmë tregon se ju keni një fëmijë që do të plotësojë kriteret për të ndjekur kopshtin në shtator 2020!

Procesi i regjistrimit

Për TË GJITHË nxënësit përfitues të kopshtit në 2020-2021 që banojnë në Braintree, pavarësisht se ku jetojnë në qytet, regjistrimi do të kryhet në mensën e **MONATIQUOT SCHOOL KINDERGARTEN CENTER**, në adresën **25 Brow Avenue, Braintree** (Kini parasysh se vend-parkimi gjendet anash Monatiquot School Kindergarten Center. Të gjithë prindërit janë të lutur të parkojnë në vend-parkim, jo në rrugë. Prindërit duhet të futen në shkollë nga hyrja kryesore në Brow Avenue).

Do të gjeni bashkëngjitur dokumentet që ju duhen për ta regjistruar fëmijën: **Këto dokumente duhen plotësuar në momentin e regjistrimit.** Keni në dispozicion tri datat dhe oraret e mëposhtme – zgjidhni **një** prej tyre, që ju duket më e përshtatshme.

Java e regjistrimit @ Monatiquot School Kindergarten Center

E martë 21 janar 2020 -- 4:00 p.m. deri 7:00 p.m.

E enjte 23 janar 2020 -- 4:00 p.m. deri 7:00 p.m.

E shtunë 25 janar 2020 -- 9:00 a.m. deri 11:00 a.m.

Pasi të përfundojë java e regjistrimit, ne do të shqyrtojmë numrin e familjeve që kërkojnë program kopshti pa drekë dhe program kopshti ditor. Do t'i njoftojmë të gjitha familjet për sistemimin që i kemi dhënë fëmijës për programin ose ditor ose pa drekë **gjatë** javës që nis më 3 shkurt 2020. Në atë kohë, nëse duhet mbajtur një lotari për kërkesat për sistemim gjithë-ditor në kopsht, familjet përkatëse do të njoftohen dhe do t'u jepet edhe informacioni për procesin e lotarisë.

LUTEMI KINI PARASYSH: Gjatë vitit shkollor 2020-2021, shumica e klasave të kopshtit ditor do të zhvillohen në Monatiquot School Kindergarten Center.

Programi i kopshtit ditor do të kushtojë \$3,500.00 në vit për nxënë. **Në qoftë se regjistrimi juaj konfirmohet për kopshtin ditor për vitin shkollor 2020-2021, do t'ju duhet të paguani një depozitë prej \$600.00 jo më vonë se data 28 shkurt 2020 për t'ia ruajtur vendin fëmijës.** Familjeve që përfitojnë nga tarifat e reduktuara, u ofrohet një tarifë mësimore e reduktuar prej \$1750.00 në vit për nxënë dhe **një shumë e reduktuar depozite prej \$300.00 që duhet paguar jo më vonë se data 28 shkurt 2020.** Për t'u kualifikuar për tarifë të reduktuar, plotësoni Formularin e Aplikacionit për Tarifë të Reduktuar. Lutemi kini parasysh se tarifa mësimore gjithsej për të gjitha familjet duhet paguar jo më vonë se data 24 korrik 2020 (shihni planin e bashkëngjitur të pagesave). Nëse keni rrethana të tilla që ju pengojnë t'i shlyeni pagesat sipas planit të bashkëngjitur të pagesave deri më datë 24 korrik 2020, kontaktoni Zyrat e Administratës me shkrim në adresën BPSKindergarten@braintreeschools.org

Shpresojmë t'ju shohim gjatë Javës së Regjistrimit në Kopsht, në Monatiquot School Kindergarten Center!

SUKSES •

KRIJIMTARI •

PËRFSHIRJE

• 348 Pond Street • Braintree, MA 02184 • Telefon (781) 380-0130. FAKS (781) 380-0146 • www.braintreeschools.org •